

ATHINË, ATY KU LINDI



DEMOKRACIA

JEMI TË BARABARTË NË DEMOKRACI

ERION (11), MEVLANA (10), RITA (10), SUELA (10), ARMELA (10), FLORENTIN (10)

Ne si fëmijë jemi të lumtur që jetojmë në një vend demokratik. A thua vallë pse? Me këtë artikull grupi ynë tregon disa fakte dhe shembuj se çka është demokracia dhe çfarë roli kemi ne në të

Demokracia rrjedh nga fjalët greke „demos“ që do të thotë popull dhe „kratia“ udhëheqje. Prandaj, me fjalën demokraci nënkuptojmë udhëheqjen e popullit. Në vitin 507 para erës sonë në Athinë, u shfaq për herë të parë forma e parë e demokracisë. Për dallim nga sot ku të gjithë i kemi të drejtat e barabarta, atëherë kanë pasur të drejtën e vendimmarrjes vetëm burrat e pasur. Kurse, gratë dhe skllevërit nuk e kishin këtë të drejtë.

Ne jetojmë në kohën kur në vendet demokratike të gjithë jemi të barabartë dhe kemi shumë të drejta, si: të drejtën për të shprehur mendimet lirshëm, të drejtën e shkollimit, të drejtën e lojës, të drejtën e votës, të drejtën e strehimit, të drejtën e familjes, etj. Në jetën tonë të përditshme kemi shumë shembuj se si ne jemi të lumtur me të drejtat që i kemi.

Arditi është nxënës në klasën e V-të. Ai është një nxënës shembullor dhe mjaft i përkushtuar, sepse çdo herë shkon në shkollë me orar dhe detyrat i kryen rregullisht. Arditi ndihet i gëzuar, sepse e ka të drejtën e shkollimit. Ai e di që duke mësuar shumë dhe duke qenë i përgjegjshëm, mund të arrij shumë suksese në të ardhmen.


Ndërsa, Sara, një personazh tjetër yni, një ditë duke u kthyer nga shkolla në shtëpi, pa një vajzë 3 vjeçare e cila qante dhe i kërkonte prindërit. Ajo e ndihmoi vajzën, duke e dërguar në stacionin më të afërt policor. Pas një ore, erdhën prindërit e saj të merakosur. Kur e panë vajzën e tyre, e përqaftuan fort dhe e falenderuan shumë Sarën që kishte ndihmuar vajzën e tyre. Pra, ne në demokraci duhet të bashkëpunojmë dhe t'i ndihmojmë njëri-tjetrit, sepse të gjithë jemi një.



Të drejtat e fëmijëve



Ne bashkëpunojmë me njëri-tjetrin



Në demokraci vendos populli



Grupi „Dituria“

PROCESI ZGJEDHOR

MUSTAFË (10), BLEND (10), AGNESA (11), ELVIRA (10), DIELLA (10)

Me plot entuziazëm dhe shumë përkushtim e shkruajtëm këtë artikull për ju. Na gëzoni shumë nëse e lexoni

Ne e dijmë se jo të gjithë e kemi shijen e njëjtë. Dikujt i pëlqen akullorja, dikujt i pëlqen çokollata, e dikujt të dyjat. E për të parë se çka i pëlqen secilit në grupin tonë, ne votuam. Dikush votoi për çokollatën, e dikush për akulloren. Kështu, kjo që bëmë ishte shumë e mirë, sepse pikërisht tema që diskutuam në grup kishte të bënte me votimin. Në bazë të asaj që thamë në grup, meqë jemi gazetarë, këto informata do t'i ndajmë me ju. Atëherë, çfarë do të thotë të votosh? Të votosh do të thotë të përdorësh të drejtën tënde. Do të thotë të thuash mendimin tënd dhe të bësh zgjedhjen tënde. Shpesh kur përmendet vota, ne mendojmë vetëm për zgjedhjet shtetërore. Mirëpo, edhe ne si fëmijë votojmë dhe zgjedhim. E përmendëm shembullin me akullore. Megjithatë, për të marrë pjesë në procesin zgjedhor mundemi vetëm pasi të arrijmë moshën 18 vjeçare. Kjo për arsye se procesi përmes të cilit ne zgjedhim udhëheqësit e vendit është aq i rëndësishëm, sa ne duhet të jemi patjetër të pjekur për të qenë pjesë e këtij procesi. Duam t'iu tregojmë se qytetarët e Kosovës marrin pjesë në dy lloje të zgjedhjeve. Janë zgjedhjet qendrore, ato që njihen si parlamentare dhe ku qytetarët zgjedhin deputetët si përfaqësues shtetëror të tyre. Po ashtu janë zgjedhjet komunale apo lokale, ku qytetarët zgjedhin kryetarët e komunave dhe asamblistët. Ne sot u kënaqëm shumë dhe mësuam shumë. Shpresojmë që edhe ju jeni kënaqur me artikullin tonë dhe keni mësuar nga ai.




Zgjedhja është e drejta jonë



Gazetarët e përgjegjshëm të demokracisë



Gjatë shkruarjes së artikullit



Voto edhe ti për të ardhmen e vendit tënd

NE JEMI PJESË E KUVENDIT

LEONIT (10), FATLUM (11), YLLNESA (10), SUELA (10), AULONA (11), VALERIA (10)

Kuvendi është institucion, vlera dhe rëndësia e të cilit është shumë e madhe. Këtë e shumë të tjera i mësuam sot në Punëtorinë e Demokracisë „Demos-ti“. Ne mësuam nga edukatorët e projektit dhe njëri-tjetri. Ndërsa, ju të dashur lexues e keni mundësinë të mësoni nga ne

E drejta për jetë dhe e drejta për arsim janë dy nga disa të drejta që të gjithë qytetarët në vendin tonë i gëzojnë. Për ne janë më të rëndësishmet, prandaj edhe i cekëm. Kur jemi tek rëndësia, ne po ashtu jemi të mendimit se edhe e drejta e familjes ka pothuajse rëndësinë e njëjtë me ato që i cekëm më lart. Këto të drejta i zbatojmë dhe mundohemi shumë që jo vetëm ne, por, asnjë nga shokët tonë të mos veprojnë në kundërshtim me to. Arsyeja pse veprojmë kështu është sepse falë këtyre të drejtave, ne rritemi dhe e pasurojmë trurin tonë më dije.


Fillimisht, ne jemi tejet falënderues ndaj vendit tonë që na mundëson këto të drejta. Pasi që jemi tek të drejtat, ne dëshirojmë t'iu tregojmë një shembull. Ne ndihemi shumë mirë dhe krenarë për mënyrën se si

kemi vepruar.


Suela shoqja jonë ka jetuar disa vite në diasporë. Pasi ajo u kthye nga diaspora, vazhdoi shkollimin në Kosovë. Por, ajo shqetësohej, sepse mendonte se do t'i merrte shumë kohë deri sa të adaptohej me ambientin e ri shkollor, si dhe të bënte shokë dhe shoqe. Ajo po ashtu hezitonte të fliste në klasë, sepse kishte paksa vështirësi në të shprehur në gjuhën shqipe. Falë kujdestares së klasës sonë, por gjithashtu edhe zemërgjerësisë sonë si klasë, ajo sot është shumë më e çlirët dhe është shumë aktive edhe në debate që i zhvillojmë në klasë. Kujdestarja na rikujtoi edhe një herë se në vendin tonë, ligjet tregojnë që të gjithë qytetarët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë. Se nga e kanë burimin këto ligje, lexojeni artikullin tjetër.



Të rinjtë të cilët në të ardhmen do të bëhen deputetë



Vizatimi që po shihni është objekti i Kuvendit të Kosovës. Të gjitha informatat që sot i morëm për këtë institucion, do të keni mundësi t'iu lexoni në artikullin tjetër



Këtu kemi paraqitur një libër me mbikshkrim për demokracinë, Ajo çka ne kemi dashur të shprehim me anë të kësaj vepre është se demokracia për ne është si libri


Ligjet, qëllimi i të cilave është sigurimi i një jetese më të mirë për qytetarët, miratohen në Kuvend. Janë gjithsej 120 deputetë, të cilët mundohen dhe punojnë për ne, popullin e Kosovës. Këta deputetë janë prej kombësive të ndryshme.

Përpos komunitetit shqiptar, kemi edhe komunitete të tjera si: boshnjak, romë, ashkali, egjiptian, goran, serb, turk. Sigurisht që numri më i madh i deputetëve janë të komunitetit apo kombësisë shqiptare. Por, një gjë duhet thënë se në vendin tonë të gjithë qytetarët, duke përfshirë këtu edhe deputetët në Kuvend trajtohen në mënyrë të barabartë. Prandaj edhe ne rritemi me frymën në të cilën Kuvendi funksionon, në barazi, në liri, në të drejtën e shprehjes së lirë, e shumë e shumë të drejta të tjera.

Të flasim pak edhe për disa nga funksionet e Kuvendit. Si tri funksione më të rëndësishme të tij janë: funksioni përfaqësues, ku Kuvendi si institucion përfaqëson interesat e popullit; funksioni legjislativ, që nënkupton miratimin e ligjeve dhe që vetëm ky institucion e gëzon këtë të drejtë. Si dhe funksion tjetër i Kuvendit është funksioni kontrollues. Kuvendi e kontrollon punën e Qeverisë për t'u siguruar që ligjet e miratuara po zbatohen ashtu siç duhet.

Kuvendi me një fjalë është bërthama e vendit tonë. Le të bëhemi qytetarë të zellshëm dhe t'i dëshmojmë këtij institucioni që edhe ne kujdesemi dhe e duam ashtu siç ai na don dhe kujdeset për ne. Këtë mund ta bëjmë duke respektuar ligjet dhe duke qenë aktiv.


Faleminderit për vëmendjen tuaj!



Disa fakte rreth zgjedhjes së deputetëve



Puna e qytetarëve aktiv në grup



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Nazim Gafurri“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: V-5
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë